



Auktorisoidun kääntäjän tutkinto 12.11.2016

Kielet ja käännössuunta
albaniasta suomeen

Aihepiiri (aukt3)
koulutus

Käännöstehtävä

Laadi liiteasiakirjasta laillisesti pätevä käännös

Lähde: <http://www.fhf.edu.al/bolonja.html>

Käännöksen käyttötarkoitus

Opiskelija on kuullut Suomen hyvistä Bolognan prosessissa ja haluaa tulla Suomeen opiskelemaan.

*Huom! Käännökseen ei saa kirjoittaa vakuuslauseketta eikä nimeä!
Vakuuslausekkeen tai nimen kirjoittaminen käännökseen johtaa
tutkintosuorituksen hylkäämiseen.*

Käännettävän tekstin pituus 2000 merkkiä

DIPLOMAT DHE PROCESI I BOLONJËS

Diplomë Universitare (DU) me kohëzgjatje jo më pak se tre vjet, ku studenti duhet të fitojë 20-30 module, të cilat vlerësohen me 180 pikë kredit, shembull: Diplomë Univerisitare-Matematikan.

Master me kohëzgjatje 2 vjet ku studenti, pasi ka marrë DU-në, do të fitojë 120 pikë kredite të tjera në një drejtim të caktuar dhe të mbrojë një mikrotezë, shembull: Master-Gjenetikë e popullatave.

Doktor (Dr) me kohëzgjatje jo më pak se 3 vjet, ku i diplomuari në master vazhdon në përgjithësi në rrugë individuale studimet dhe mbron një temë shkencore.

Diploma e Specializimit (DS), me kohëzgjatje 1-3 vite. Kjo diplomë jepet për degët e mësuesisë (Diplomë e mësuesisë (DM), me kohëzgjatje 1 vjeçare.

Ndryshimet që sjellë procesi i Bolonjës në universitetet shqiptare

Së pari, studenti konsiderohet si një punonjës më 40 orë punë në javë dhe, si i tillë, ai do të plotësojë detyrat e tij në frekuentim e përgatitje. Në këtë proces, ai do të ndihmohet nga një pedagog kujdestar, i cili mban lidhje me studentët, si dhe nga gjithë pedagogët, të cilët janë të detyruar të zhvillojnë rregullisht konsultime.

Së dyti, marrja e një specialiteti në këto kurrikula e lë të lirë studentin të zgjedhë gjatë dhe mbas jetës universitare module dhe drejtime formuese sipas kërkesave të tregut. P.sh. një student që ka mbaruar një degë në shkencat teknike apo bujqësore mund të ndjekë Diplomën e Mësuesisë, etj.

Së treti, lëvizjet e studentëve nga një universitet në tjetrin, nga një shtet në tjetrin është një normë e shoqërisë së ardhme në hapësirën evropiane. Nga ky këndvështrim merr një rëndësi të vecantë integrimi kulturor dhe njohja e gjuhëve të huaja.

Së katërti, do të kryhet kontrolli i cilësisë në nivelin institucional, kombëtar e evropian në bazë të kriterëve dhe standardeve të caktuara. Ky kontroll i cilësisë ndërgjegjëson nga njëra anë studentin dhe nga ana tjetër universitetet, të cilat janë të detyruara të ngrenë zyrat e verësimit dhe të vetëvlerësohen.

Praktika e akreditimit të universiteteve është alternativa bazë e funksionimit të tyre.

Një vit akademik përbëhet nga 30 javë mësimore, ku çdo javë studenti do të zhvillojë rreth 20-30 orë 60 minutëshe në auditor. Lëshimi i diplomës universitare shoqërohet me një Diplomë Shtesë, në të cilën shënohen modulet me kreditet dhe nota përkatëse e studentit sipas një sistemi vlerësimi të quajtur ECTS.